

## PROJEKTLIGJ

### “PËR NËNPRODUKTET ME ORIGJINË SHTAZORE<sup>1</sup>”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

#### KREU 1

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

#### **Qëllimi**

Ky ligj përcakton rregullat e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve për nënproduktet e kafshëve dhe produktet e derivuara, me qëllim parandalimin dhe minimizimin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve që rrjedhin nga këto produkte, dhe në veçanti për të mbrojtur sigurinë e zinxhirit ushqimor dhe ushqimeve.

Neni 2

#### **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për:

- a) nënproduktet me origjinë shtazore të cilat nuk konsumohen nga njerëzit dhe për produktet derivate të prodhuara nga përpunimi i tyre;
- b) produktet që vijnë më poshtë, të cilat janë ushqime me origjinë shtazore ose përmbajnë produkte me origjinë shtazore, të cilat për shkak se nuk përmbushin më kushtet e përdorimit si ushqim për njerëzit, pas vendimit të marrë nga operatori i biznesit ushqimor ose autoriteti kompetent nuk përdoren më si ushqim për njerëz. Këto produkte janë:

---

<sup>1</sup> Ky ligj përafrohet rregulloren (KE) n. 1069/2009 të Parlamentit evropian dhe Këshillit, dt. 21 tetor 2009 “Që përmban normat sanitare që i përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore dhe derivateve të tyre të cilat nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 1774/2002 (rregullore mbi nënproduktet me origjinë shtazore)” (GZ L 300 dt. 14.11.2009, faq. 1)

- i) produkte me origjinë shtazore që ishin të destinuar për konsum nga njerëzit sipas kërkesave të legjislacionit të ushqimit;
  - ii) lëndë të para për prodhimin e ushqimeve me origjinë shtazore.
2. Ky ligj nuk zbatohet për produktet me origjinë shtazore që vijojnë:
- a) Kadavra të plota ose pjesë të kafshëve të egra, të ndryshëm nga kafshët e gjuetisë të cilat nuk dyshohet të jenë të infektuara ose të prekura nga sëmundje e transmetueshme tek njerëzit ose tek kafshët, me përjashtim të kafshëve të ujit të zëna për qëllime tregtare;
  - b) Kadavra të plota ose pjesë të kafshëve të gjuetisë të cilat pas vrasjes, nuk janë mbledhur në përputhje me praktikën e mira të gjuetisë;
  - c) nënproduktet me origjinë shtazore që rrjedhin nga kafshët e egra dhe mishit i kafshëve të egra;
  - ç) ovocitet, embrionet dhe sperma të destinuar për riprodhim;
  - d) qumështi i pa përpunuar, kulloshtira dhe produktet që rrjedhin nga ato të përfituara, të ruajtura, të eliminuara ose përdorura në fermën e origjinës;
  - dh) guacat dhe mburojat kockore të molusqeve të cilave i janë hequr indet e buta dhe mishit, me përjashtim të atyre që kanë në përmbajtje inde të buta;
  - e) mbetjet e guzhinave dhe restoranteve, përjashtuar mbetjet:
    - i) që vijnë nga mjetet e transportit që kanë kryer udhëtime ndërkombëtare;
    - ii) të destinuar për tu përdorur si ushqim për kafshë;
    - iii) të destinuar për sterilizim nën presion, për transformim nëpërmjet metodave të përshkruara nga neni 15 pika 1, gërma b), për transformim në biogas ose kompostim;
  - ë) materialet që vijnë nga anijet e peshkimit, të cilat përpunojnë peshkun e zënë gjatë lundrimit mund të hidhen në det, duke respektuar legjislacionin për mjedisin, përjashtuar materialet që rrjedhin nga pastrimi (rrjepja) e peshkut në bordin e anijes dhe që shfaqin shenja të një sëmundje të transmetueshme për njerëzit ose/dhe kafshët, përfshirë sëmundjet parazitare;
  - f) ushqime të pa përpunuara për kafshët e shoqërimit që vijnë nga bizneset e shitjes me pakicë, të cilat kanë si qëllim shitjen e mishit direkt tek konsumatori;
  - g) ushqime të pa përpunuara për kafshët e therura në fermë dhe të destinuar për konsum privat në shtëpi; dhe
  - gj) jashtëqitjet dhe urina, që nuk vijnë nga plehu i stallës dhe plehu i shpendëve i pa mineralizuar.
3. Ky ligj respekton normativat në fushën e veterinarisë që kanë si synim çrrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve.

Neni 3  
**Përkufizime**

Termet e përdoruar në këtë ligj kanë këto kuptime:

1. “Nënprodukte me origjinë shtazore”, kadavra të plotë ose pjesë të kadavrave të kafshëve, produkte me origjinë shtazore ose produkte të tjera të përfituara nga kafshët, që nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit, përfshirë ovocitet, embrionet dhe spermën;
2. “Produkte derivate”, produkte të përfituara nëpërmjet një ose me shumë trajtimeve, transformimeve ose fazave të përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore;
3. “Produkte me origjinë shtazore”, që vijojnë :
  - a) ushqime me origjinë shtazore përfshirë mjaltin dhe gjakun;
  - b) molusqet bivalvorë të gjallë, echinoderma të gjalla, tunikate të gjalla, gastropodet detare të gjallë dhe të destinuara për konsum nga njerëzit;
  - c) kafshë të tjera, të cilat i furnizohen konsumatorit të gjalla.
4. “Karkasa”, trupi një kafshe pas therjes dhe kryerjes së toletaturës;
5. “Kafshë”, çdo lloj kafshe vertebrorë ose jo vertebrorë;
6. “Kafshë mbarështimi”:
  - a) një kafshë e mbajtur, majmur ose rritur nga njeriu dhe përdorur për prodhimin e ushqimeve, leshit, lëkurëve, puplave, qimeve ose çdo lloj prodhimi tjetër të përfituar nga kafshët ose për qëllime të tjera rritjeje;
  - b) njëthundrakët.
7. “Kafshë e egër”, një kafshë e cila nuk mbahet nga njeriu;
8. “Kafshë shoqërimi”, një kafshë që i përket një lloji kafshe e cila zakonisht mbahet dhe ushqehet nga njeriu për qëllime të tjera nga mbarështimi, por që nuk konsumohet nga njeriu;
9. “Kafshë e ujit”, kafshë të ujit sipas përcaktimeve të ligjit të shëndetit të kafshëve;
10. “Operator”, person fizik ose juridik që ushtron kontroll praktik mbi nënproduktet me origjinë shtazore ose derivatet e tyre, përfshirë transportuesit, tregtarët dhe përpunuesit;
11. “Përdorues”, person fizik ose juridik që përdorin nënprodukte me origjinë shtazore dhe produkte derivate për ushqimin e kafshëve të cilat mbarështohen për përdorim të veçantë, me qëllim të kërkimit ose qëllime të tjera shkencore;
12. “Stabiliment” ose “Impiant”, çdo vend, përjashtuar anijet e peshkimit, në të cilat zhvillohet çdo lloj veprimtarie që sjell përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate;
13. “Futje në treg”, çdo veprimtari që ka si qëllim shitjen tek të tretët, të nënprodukteve me origjinë shtazore, të produkteve derivate që rrjedhin nga përpunimi i tyre ose çdo lloj tjetër formë e furnizimit ndaj të tretëve me qëllim përfitimi, falas ose që bën magazinim me qëllim furnizimin e mëvonshëm të palëve të treta;
14. “Transit”, transiti siç përcaktohet për kontrollet zyrtare;

15. “Eksport”, lëvizja e nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe derivateve të tyre në drejtim të një vendi tjetër;
16. “Encefalopatitë Spungiforme të Transmetushme (TSE)”, të gjitha encefalopatitë spungiforme të transmetushme sipas përcaktimeve të legjislacionit mbi TSE-të;
17. “Material specifik me rrezik”, material specifik që paraqet rrezik sipas përcaktimeve të legjislacionit mbi TSE-të;
18. “Sterilizim nën presion”, trajtimi i nënprodukteve me origjinë shtazore pas copëtimit në copa jo më të mëdha se 50 mm, në një temperaturë më të lartë se 133 °C në qendrën e copës më të madhe për të paktën 20 minuta pa ndërprerje, në një presion absolut prej të paktën 3 bar;
19. “Plehu i stallës”, jashtëqitjet dhe/ose urina e kafshëve të mbarështimit të ndryshëm nga peshqit e mbarështimit me ose pa shtresë;
20. “Landfill i autorizuar”, një vend i autorizuar sipas kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin e mbetjeve;
21. “Plehu organik” dhe “Fertilizant organik”, materiale me origjinë shtazore të përdorura, së bashku ose të ndara, për të ruajtur ose përmirësuar të ushqyerit e bimëve dhe cilësitë fiziko-kimike të tokës dhe aktivitetit biologjik të tyre, ku mund të përfshihet plehu i stallës, përmbajtja e tubit digjestiv, produktet e kompostimit dhe mbetjet e të ushqyerit;
22. “Zona e izoluar”, një zonë në të cilën dendësia e popullatës së kafshëve është shumë e ulët dhe ku stabilimentet ose impiantet hedhjes së mbetjeve janë shume larg nga njera-tjetra, si pasojë kërkesat e nevojshme për mbledhjen ose transportin e produkteve me origjinë shtazore do të ishin tepër të kushtueshme përkundrejt asgjësimit në vend;
23. “Ushqim” ose “Produkt ushqimor”, një ushqim ose një produkt ushqimor siç përcaktohet në legjislacionin mbi ushqimin;
24. “Ushqim për kafshë” një ushqim për kafshë siç përcaktohet në legjislacionin mbi ushqimin;
25. “Mbetja e centrifugimit ose e ndarjes”, material i mbledhur si nënprodukt pas procesit të centrifugimit të qumështit të pa përpunuar dhe të ndarjes së qumështit të skremuar nga kremi i qumështit të pa përpunuar;
26. “Mbetje”, mbetje sipas përcaktimit të legjislacionin mbi mjedisin;
27. “Silazhim”, një formë e përpunimit të ushqimit për kafshë;
28. “Autoritet Kompetent Qëndror” është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
29. “Autoritete Kompetente Vendore” janë institucionet shtetërore të përcaktuara nga legjislacioni për kontrollet zyrtare.
30. “Markues”, një substancë inerte e cila i shtohet një nënprodukti me origjinë shtazore ose një produkti derivat, i cili nuk merr pjesë në procesin e përpunimit, nuk ndryshon karakteristikat fizike dhe biokimike të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate;
31. “Markim”, procesi i shtimit dhe i gjurmimit të një markuesi në nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate;

32. "Mbetje me origjinë shtazore", nënkupton një nënprodukt me origjinë shtazore, të cilën zotëruesi e eliminon apo është i detyruar ta eliminojë në pamundësi përpunimi ose për shkak të detyrimit ligjor.
33. "Kontrolli zyrtar" kontrolli i cili ushtrohet nga institucionet e përcaktuara sipas legjislacionit mbi kontrollin zyrtar.

## KREU 2

### ZINXHIRI PRODHIMIT, DETYRIMET DHE KUFIZIMET

#### Neni 4

##### **Pika e fillimit në zinxhirin e prodhimit dhe detyrimet**

1. Operatorët të cilët prodhojnë nënprodukte shtazore ose derivate të tyre që hyjnë në fushën e aplikimit të këtij ligji, në praninë e veterinerit zyrtar përcaktojnë kategorinë, i regjistrojnë dhe marrin masa në mënyrë që të trajtohen në përputhje me këtë ligj (Pika e fillimit).
2. Në të gjitha fazat e mbledhjes, transportit, menaxhimit, trajtimit, transformimit, përpunimit, magazinimit, futjes në treg, shpërndarjes, përdorimit dhe asgjesimit në biznes, operatorët duhet të marrin masa me qëllim që nënproduktet me origjinë shtazore dhe derivatet e tyre të respektojnë kërkesat e këtij ligji.
3. Autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare, kontrollon dhe verifikon respektimin e kërkesave përkatëse të këtij ligji nga ana e operatorëve gjatë gjithë zinxhirit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe derivateve të tyre sipas kërkesave të pikës 2. Për këtë qëllim, ata krijojnë një sistem regjistrimi të kontrolleve zyrtare.
4. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar veterinar, në territorin ku zhvillon aktivitetin zyrtar merr masa për vendosjen e një sistemi regjistrimi të përshtatshëm, për të garantuar që nënproduktet me origjinë shtazore:
  - a) të mblidhen, identifikohen dhe transportohen pa vonesa të panevojshme dhe
  - b) të trajtohen, përdoren ose eliminohen në respekt të këtij ligji.

#### Neni 5

##### **Pika fundore në zinxhirin e prodhimit**

1. Produktet derivate sipas përshkrimeve të *neni 30*, të cilat arrijnë në fazën e përpunimit, konsiderohen si produkte që kanë arritur pikën fundore të zinxhirit të prodhimit, dhe nuk janë më objekt i kërkesave të këtij ligji. Këto produkte derivate mund të futen më pas në treg pa kufizime sipas kërkesave të këtij ligji dhe nuk janë më objekt i kontrolleve zyrtare në përputhje me këtë ligj.
2. Pika fundore e zinxhirit të prodhimit mund të modifikohet:

- a) për produktet sipas *nënit 31*, nga gërma a) tek gërma ç), në rast të rrezikut për shëndetin e kafshëve;
  - b) për produktet sipas *nënit 32*, gërma d) dhe gërma dh), në rast të rrezikut për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve.
3. Për produktet derivate sipas *neneve 31, 34 dhe 35* të cilat nuk paraqesin më rrisht për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, mund të përcaktohet një pikë fundore në zinxhirin e prodhimit përtej të cilit nuk mund të jenë më subjekt i kërkesave të këtij ligji. Këto produkte derivate mund të futen më pas në treg pa kufizime të mëtejshme sipas kërkesave të këtij ligji dhe nuk mund të jenë me subjekt i kontroleve zyrtare në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

#### Neni 6

### **Kufizime të përgjithshme që rrjedhin nga shëndeti i kafshëve**

1. Nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate të cilat preken nga një sëmundje e listuar, nuk mund të lëvizin jashtë fermave, stabilimenteve, impianteve dhe zonave të cilat janë subjekt i kufizimeve:

- a) sipas kërkesave të legjislacionit në fushën e veterinarisë; ose
- b) për shkak të prezencës së një sëmundje të transmetueshme të listuar të hartuar sipas legjislacionit mbi shëndetin e kafshëve.

2. Pika 1 e këtij neni, nuk aplikohet kur nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate lëvizin me qëllim prandalimin e përhapjes së sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit ose tek kafshët.

#### KREU 3

### KATEGORIZIMI

#### Neni 7

### **Kategorizimi i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate**

Nënproduktet me origjinë shtazore janë të ndara në kategori specifike që reflektojnë nivelin e tyre të rrezikut për shëndetin e njerëzve ose/dhe të kafshëve, në përputhje me listat e hartuara sipas kërkesave të *neneve 8, 9 dhe 10*.

#### Neni 8

### **Materialet e Kategorisë 1**

Materialet e kategorisë 1 përfshijnë nënproduktet me origjinë shtazore që vijojnë:

- a) kadavra të plota ose pjesë të karkasave përfshirë lëkurët e kafshëve, që vijojnë:

- i) kafshë të dyshuara se janë të infektuara nga TSE (Encefalopatitë Spungiforme të Transmetushme) ose prezenca e TSE është e konfirmuar zyrtarisht;
  - ii) kafshë të eliminuara në kuadër të masave të çrrënjësjes së TSE;
  - iii) kafshë që nuk janë as kafshë mbarështimi dhe as kafshë të egra, si dhe kafshët e shoqërimin, kafshët e kopshteve zoologjike dhe kafshët e cirqeve;
  - iv) kafshë të përdorura në një procedurë ose në procedura të përcaktuara mbi mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore në rastet në të cilat, autoriteti kompetent për kontrollet zyrtare , vendos që kafshë të tilla ose pjesë të kadavrave të tyre mund të paraqesin rrisht për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve;
  - v) kafshë të egra, nëse ka dyshim që janë të infektuara nga sëmundje të transmetushme tek njerëzit ose kafshët.
- b) materialet që vijojnë:
- i) materiale që paraqesin një rrisht specifik;
  - ii) kadavra të plota ose pjesë të tyre nga kafshë të ngordhura që përmbajnë materiale që paraqesin rrisht specifik në momentin e eliminimit.
- c) nënproduktet me origjinë shtazore të përfituara nga kafshë që i janë nënshtruar trajtimeve të paligjshme;
- ç) nënproduktet me origjinë shtazore që përmbajnë mbetje të substancave farmakologjike të ndaluara të përdoren dhe kontaminantë për ambientin sipas përcaktimeve të legjisllacionit përkatës, nëse mbetje të tilla tejkalojnë nivelet e lejuara nga legjisllacioni përkatës në fuqi;
- d) nënproduktet me origjinë shtazore të mbledhur në fushën e trajtimit të ujërave të kullimit sipas kërkesave për marjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 15, pika 2, gërma c):
- i) nga stabilimente ose impiante që transformojnë materiale të kategorisë 1; ose
  - ii) nga stabilimente ose impiante në të cilat është hequr materiali i rrezikshëm specifik (TSE).
- dh) mbetje ushqimore me prejardhje nga mbetjet e transportit që kryejnë udhëtime ndërkombëtare;
- e) përzierjet e materialeve të kategorisë 1 me materiale të kategorisë 2 dhe/ose 3.

## Neni 9

### Materiale të kategorisë 2

Materialet e kategorisë 2 përfshijnë nënproduktet me origjinë shtazore që vijojnë:

- a) plehu i stallës, plehu i shpendëve i pa mineralizuar dhe përmbajtja e tubit tretës;
- b) nënproduktet me origjinë shtazore, të mbledhura nga trajtimi i ujërave të kullimit sipas kërkesave për marjen e masave në përputhje me kërkesat e nenit 15, pika 2 , gërma c), që vijojnë:
  - i) nga stabilimente ose impiante që transformojnë materiale të kategorisë 2; ose
  - ii) nga thertore të ndryshme nga ato të përshkruara në nenin 8, gërma d).

- c) nënproduktet me origjinë shtazore që përmbajnë mbetje të substancave farmakologjike ose ndotës të autorizuar por që tejkalojnë nivelet e lejuara sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) produkte me origjinë shtazore që janë të deklaruar si jo të përshtatshme për konsum nga njerëzit për shkak të prezencës së trupave të huaj në këto produkte;
- d) produkte me origjinë shtazore, të ndryshme nga materialet e kategorisë 1 që janë:
  - i) importuar por që nuk respektojnë legjislacionin mbi shërbimin veterinar për importimin tyre, me përjashtim të rasteve në të cilat legjislacioni lejon importin ose eksportin e tyre në përputhje me kufizime specifike; ose
  - ii) të eksportuara por që nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara ose të autorizuar nga legjislacioni i shtetit importues, me përjashtim të rastit kur janë eksportuar me autorizim nga autoriteti kompetent i shtetit importues;
- dh) kafshë ose pjesë të kafshëve, të ndryshme nga ato të përshkruara nga neni 8 ose neni 10:
  - i) të cilat nuk janë thërrur për konsum nga njerëzit ose eliminuar në kuadër të masave të çrrënjësjes së një sëmundjeje të caktuar;
  - ii) fetuseve;
  - iii) ovociteve, embrioneve dhe spermës që nuk janë të destinuar për riprodhim dhe
  - iv) zogjtë e shpendëve që ngordhin në vezë.
- e) përzierjet e materialeve të kategorisë 2 me materiale të kategorisë 3;
- ë) nënproduktet me origjinë shtazore që nuk janë materiale të kategorive 1 dhe 3.

#### Neni 10

#### **Materialet të kategorisë 3**

Materialet e kategorisë 3 përfshijnë nënproduktet me origjinë shtazore që vijojnë:

- a) karkasa ose pjesë të kafshëve të gjahut të thërrura, karkasa të plota ose pjesë të karkasave të kafshëve të gjahut të vrara dhe të deklaruar të përshtatshme për konsum nga njerëzit në përputhje me **normativat kombëtare** por që nuk janë më të destinuar për konsum nga njerëzit për arsye tregtare;
- b) karkasa ose pjesët që vijojnë të cilat rrjedhin nga kafshë të thërrura në një thertore për konsum nga njerëzit pas kontrollit para thërrjes ose karkasa dhe pjesë të karkasave të kafshëve të gjahut të vrara për konsum nga njerëzit në përputhje me legjislacionin kombëtar, si vijon:
  - i) karkasa ose pjese të tyre të refuzuara pasi nuk janë në përputhje për konsum nga njerëzit në përputhje me legjislacionin kombëtar, por që nuk shfaqin shenja të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose kafshët;
  - ii) kokat e shpendëve;
  - iii) lëkurët përfshirë fragmentet ose copat e prera, brirë thundra, përfshirë këmbët dhe kockat karpike e metakarpike të kafshëve të ndryshme nga ruminantet subjekt i detyrimit për testim të TSE dhe të ruminantëve që i janë nënshtruar testeve që kanë dhënë rezultat negativ për TSE;



- iv) qimet e derrave;
  - v) pupla.
- c) nënproduktet me origjinë shtazore nga shpendë dhe logomorfë të therur në fermë për konsum për njerëzit dhe që nuk kanë asnjë shenjë të sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit ose kafshët;
- ç) gjaku i kafshëve të cilat nuk kishin shenja klinike të sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit ose kafshët nëpërmjet gjakut, i përfituar nga kafshët e therura në thertore, pasi janë konsideruar të përshtatshme për therje, pas kontrollit veterinar para therjes, në përputhje me legjislacionin kombëtar, që rrjedh nga:
- i) kafshë të ndryshme nga ruminantët subjekt i detyrimit të kryerjes së testimit për TSE, dhe
  - ii) ruminantët që i janë nënshtruar testeve dhe që kanë dhënë rezultat negativ për testim të TSE;
- d) nënproduktet me origjinë shtazore që rrjedhin nga prodhimi produkteve të destinuara për konsum nga njerëzit, përfshirë mbetjet e përpunimit të dhjavit të kafshëve, kockave të cilave ju është hequr dhjami, mbetjet e centrifugimit ose mbetjet e përpunimit të qumështit;
- dh) produkte me origjinë shtazore, ose produkte ushqimore që përmbajnë produkte me origjinë shtazore, të cilat nuk janë më të destinuara për konsum për njerëzit për arsye tregtare ose për probleme të shkaktuara gjatë prodhimit apo defekte të ruajtjes së temperaturës dhe defekte të tjera që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve;
- e) ushqime për kafshët e shoqërimin, për kafshë me origjinë shtazore ose ushqime për kafshë që përmbajnë nënprodukte me origjinë shtazore ose produkte derivate, që nuk janë më të destinuara për përdorim në ushqimet e kafshëve për arsye tregtare ose për shkak të defekteve të ambalazhimit apo defekte të tjera që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve;
- ë) gjaku, placenta, leshi, puplat, qimet, brirët, fragmente të thundrave dhe qumësht i pa përpunuar që rrjedh nga kafshë të gjalla dhe që nuk paraqesin shenja të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose kafshët nëpërmjet këtyre produkteve;
- f) kafshët e ujit dhe pjesë të tyre, përjashtuar mamiferët e detit, që nuk paraqesin shenja të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose kafshët;
- g) nënprodukte shtazore të kafshëve të ujit që rrjedhin nga stabilimente ose impiante prodhimi të produkteve të destinuara për njerëzit;
- gj) materialet që rrjedhin nga kafshë që nuk kishin shenja klinike të sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit ose kafshët nëpërmjet këtyre materialeve:
- i) guackat ose mburojat kockore të krostaceve dhe molusqeve që përmbajnë inde të buta ose mish;
  - ii) produktet që vijnë të cilat rrjedhin nga kafshët e tokës të cilat janë: nënprodukte të qëndrave të inkubacionit; vezë; nënprodukte të vezëve, përfshirë guacat e vezëve;
  - iii) zogj një ditësh të eliminuar për arsye tregtare.

- h) jo vertebrorë të tokës dhe të ujit, të ndryshëm nga llojet patogjenë për njerëzit ose për kafshët;
- i) kadavra ose pjesë të tyre që i përkasin kafshëve të rendeve Rodentia dhe Lagomorpha, përjashtuar materialet e kategorisë 1 sipas nenit 8 , gërma a), pikat iii), iv) dhe v), dhe të kategorisë 2 sipas nenit 9, nga gërma a) tek gërma e);
- j) lëkurë, thundra, pupla, leshi, brirë, qime të përfituara nga kadavra të kafshëve të ngordhura dhe që nuk paraqitnin asnjë shenjë të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose kafshët nëpërmjet këtyre produkteve, të ndryshëm nga ato të përshkruara në gërmën b) të këtij neni;
- k) inde dhjamore që rrjedhin nga kafshë që nuk paraqitnin shenja klinike të sëmundjeve të transmetueshme për njerëzit ose kafshët nëpërmjet këtyre materialeve, të përfituara nga kafshë të therura në thertore dhe të konsideruara të përshtatshme për konsum nga njerëzit, në momentin e therjes pas kryerjes së kontrollit veterinar para therjes në përputhje me kërkesat e legjislacionit për shërbimin veterinar;
- l) mbetjet e kuzhinave dhe të restoranteve të ndryshme nga ato të përshkruara në nenin 8, gërma dh).

#### KREU 4

### ELIMINIMI DHE PËRDORIMI I NËNPRODUKTEVE ME ORIGJINË SHTAZORE DHE I PRODUKTEVE DERIVATE

#### Neni 11

#### **Kufizimet e përdorimit**

1. Është i ndaluar përdorimi i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate për:
  - a) ushqimin e llojeve të caktuara të kafshëve të tokës, përjashtuar kafshët për prodhimin e lëkurëve, me proteina shtazore të transformuara të përfituara nga karkasa të plota të kafshëve ose pjesë të tyre të njëjtit lloj;
  - b) ushqimin e kafshëve të mbarështuara të ndryshme nga ato që përdoren për prodhimin e lëkurëve me mbetje të kuzhinës dhe restorantit ose lëndë të para për ushqimet e kafshëve të përfituara nga këto mbetje ose derivate të tyre;
  - c) ushqimin e kafshëve të mbarështuara me bimë të egra në kullota ose të dhëna pas mbledhjes së tyre në kullota që janë në toka në cilat janë aplikuar fertilizantë organik ose pleh organik i ndryshëm nga plehu i stallës, me përjashtim të rastit kur kullotja ose mbledhja e barit në ato kullota kryhet pas përfundimit të periudhës prej të paktën 21 ditë nga aplikimi i tyre, me qëllim që të garantohet kontrolli i rrezikut për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve; dhe
  - ç) ushqimin e peshqve të mbarështuar me proteina shtazore të transformuara të përfituara nga karkasa ose pjesë të karkasave të peshqve të mbarështuar të të njëjtit lloj.

2. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar , merr masa të cilat i përkasin:
- a) verifikimeve dhe kontrolleve zyrtare që kryhen për të garantuar zbatimin e masave ndaluese sipas pikës 1, përfshirë metodat e analizave dhe provat që do të përdoren për të verifikuar prezencën e proteinave shtazore të transformuara sipas pikës 1, gërma a) dhe ç), të shkaktuara nga kontamini aksidental ose i pa parandalushëm;
  - b) kontrollit të kushteve të ushqimit të kafshëve për prodhimin e lëkurëve me proteina shtazore të transformuara të përfituara nga karkasa ose pjesë të karkasave të kafshëve të njëjtit lloj; dhe
  - c) kontrollit të ushqimeve për kafshët e mbarështuara me bimë të egra që vijnë nga toka në të cilat janë aplikuar fertilizantë organik ose plehra organike, në veçanti masa që nuk respektojnë periudhën e pritjes sipas kërkesave të pikës 1, gërma c).

#### Neni 12

### **Eliminimi dhe përdorimi i materialeve të kategorisë 1**

Materialet e kategorisë 1:

- a) eliminohen si mbetje nëpërmjet djegies (incenerim):
  - i) direkt, pa transformim paraprak; ose
  - ii) pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent e urdhëron dhe markimin e materialit përfundimtar.
- b) materialet e kategorisë 1 mund të ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë (ko-incenerim):
  - i) direkt, pa transformim paraprak; ose
  - ii) pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë permanente.
- c) eliminohen nëpërmjet procesit të sterilizimit nën presion, me markim permanent të materialit përfundimtar dhe groposjen në një landfill të autorizuar, atëherë kur bëhet fjalë për materiale të kategorisë 1 të ndryshëm nga ato të përshkruara në nenin 8, gërma a), pikat i) dhe ii);
- ç) eliminohen nëpërmjet groposjes në landfill të autorizuar, nëse bëhet fjalë për materiale të kategorisë 1 sipas nenin 8, gërma dh);
- d) përdoren si lëndë djegëse pas transformimit ose pa transformim paraprak.

#### Neni 13

### **Eliminimi dhe përdorimi i materialeve të kategorisë 2**

Materialet e kategorisë 2:

- a) eliminohen si mbetje nëpërmjet djegies (incenerim):
  - i) direkt, pa transformim paraprak; ose
  - ii) pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyrë të përhershme.

- b) atëherë kur materialet e kategorisë 2 janë mbetje, ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë (koincenerim):
- i) direkt, pa transformim paraprak; ose
  - ii) pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion nëse autoriteti kompetent e urdhëron dhe materiali përfundimtar markohet në mënyre të përhershme.
- c) eliminohen në një landfill të autorizuar pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion dhe materiali përfundimtar markohet në mënyre të përhershme;
- ç) përdoren për prodhimin e fertilizantëve organik ose plehrave organike për ti futur në treg në përputhje me kërkesat e nenit 31, pas transformimit nëpërmjet sterilizimit nën presion kur është e mundur dhe bëhet markimi permanent i materialeve përfundimtare;
- d) kompostohen ose transformohen në biogas:
- i) pas sterilizimit nën presion dhe materiali përfundimtar markohet përfundimisht; ose
  - ii) nëse bëhet fjalë për pleh stalle, për tubin digjestiv dhe përmbajtjen e tij, për qumësht, produkte me bazë qumështi, kulloshtër, vezë dhe produkte të tyre pas transformimit paraprak ose pa transformim paraprak, atëherë kur autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar vlerëson se nuk ka rrisht për përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme.
- dh) aplikohen në tokë pa transformim paraprak, nëse bëhet fjalë për plehun e stallës, të përmbajtjes së tubit digjestiv të ndarë nga tubi digjestiv, për qumësht, produkte me bazë qumështi dhe kulloshtër, nëse autoriteti përgjegjës për kontrollin zyrtar, vlerëson se nuk ka rrezik për përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme;
- e) silazhohen, kompostohen ose transformohen në biogas, nëse janë materiale derivate nga kafshët e ujtit;
- ë) përdoren si lëndë djegëse pas transformimit ose pa transformim paraprak;
- f) përdoren për prodhimin e produkteve derivate sipas kërkesave të neneve 34, 35 dhe 37 dhe futen në treg në përputhje me këto nene.

#### Neni 14

### **Eliminimi dhe përdorimi i materialeve të kategorisë 3**

Materialet e kategorisë 3:

- a) eliminohen si mbetje nëpërmjet djegies, pas transformimit paraprak ose pa transformim paraprak;
- b) ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë pas transformimit paraprak ose pa transformim paraprak;
- c) eliminohen në një landfill të autorizuar, pas transformimit;
- ç) transformohen, me përjashtim të materialeve të kategorisë 3 që kanë pësuar një proces dekompozimi ose kalbëzimi të tillë sa të paraqesin rrisht për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve nëpërmjet përdorimit të këtyre produkteve dhe që përdoren:
  - i) për prodhimin e ushqimeve për kafshët e mbarështuara të ndryshme nga kafshë që përdoren për prodhimin e lëkurëve të cilat futen në treg sipas nenit 32 të këtij ligji, me

- përrjashtim të rasteve kur kemi të bëjmë me materiale të pëshkruara në nenin 10, gërma j), k) dhe l);
- ii) për prodhimin e ushqimeve të kafshëve të prodhimit të lëkurëve, dhe që do të futen në treg në përputhje me nenin 35;
- iii) për prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërimit dhe që do të futen në treg në përputhje me nenin 34 ose
- iv) për prodhimin e fertilizantëve organikë ose të plehut organik dhe që do të futen në treg në përputhje me nenin 31.
- d) përdoren për prodhimin e ushqimeve të pa përpunuara për kafshët e shoqërimit dhe që do të futen në treg në përputhje me nenin 34;
- dh) kompostohen ose transformohen në biogas;
- e) silazhohen, kompostohen ose transformohen në biogas nëse janë materiale që rrjedhin nga kafshët e ujit;
- ë) përdoren, në kushte të përcaktuara nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, të vendosura për të parandaluar rriskun për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, kur bëhet fjalë për guaska ose mburoja kockore të krostaceve dhe të molusqeve të ndryshme nga ato të përkshkruara në nenin 2, pika 2, gërma dh) dhe lëvozhgat e vezëve;
- f) përdoren si lëndë djegëse pas transformimit ose pa transformim paraprak; ose
- g) përdoren për prodhimin e produkteve derivate sipas nenin 32,33 dhe nenin 35 dhe futen në treg sipas kërkesave të këtyre neneve;
- gj) transformohen nëpërmjet sterilizimit nën presion ose nëpërmjet metodave të përkshkruara në nenin 15, pika 1, gërma b), kompostohen ose transformohen në biogas, nëse bëhet fjalë për mbetjet e kuzhinës dhe restorantit sipas kërkesave të nenit 10, gërma l); ose
- h) hidhen në tokë pa transformim paraprak, nëse bëhet fjalë për plehun e stallës, të përmbajtjes së tubit digjestiv i ndarë nga vete tubi digjestiv, qumësht, produkte me bazë qumështi produkte me bazë qumështi dhe kullosh tërë nëse autoriteti përgjegjës për kontrollet zyrtare, vlerëson se nuk ka rrezik për përhapjen e sëmundjeve të rënda të transmetueshme;

## Neni 15

### Masat e zbatimit

1. Masat e përcaktuara për nenet 12,13 dhe 14 aplikohen për:
  - a) kushtet e veçanta për përpunimin në bordin e anijeve dhe eliminimin e materialeve që vijnë nga heqja e të brendshmeve të peshqve të cilat paraqesin shenja të sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit, përfshirë parazitozat;
  - b) metodat e trajtimit të nënprodukteve me origjinë shtazore që nuk janë metoda sterilizimi nën presion, në veçanti për parametrat e sterilizimit nën presion, si koha, temperatura, presioni dhe madhësia e grimcave;

- c) parametrat e transformimit të nënprodukteve me origjinë shtazore, përfshirë mbetjet e guzhinës dhe restorantit, në biogas dhe komposto;
- ç) kushtet e djegies dhe djegien për prodhim të energjisë të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produktet derivate;
- d) kushtet e djegies së nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate;
- dh) kushtet për prodhimin dhe përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore sipas nenit 10, gërma c);
- e) silazhimin e materialeve që rrjedhin nga kafshët e ujit;
- ë) markimin permanent të nënprodukteve me origjinë shtazore;
- f) hedhjen në tokë të nënprodukteve me origjinë shtazore, fertilizantëve organik dhe plehut organik;
- g) përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore për ushqimin e kafshëve të mbarështimit; dhe
- gj) nivelin e rrishtit për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve e lidhur me disa materiale të konsideruara si të papranueshme sipas përshkrimeve të nenin 14, gërma ç).

2. Masat e përcaktuara për nenet 23,24, 25 dhe 26 aplikohen për:

- a) masat që i aplikohen strukturës dhe mjeteve të punës në stabilimente ose në impiante;
- b) masat në fushën e higjienës të aplikueshme në të gjitha tipat e përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate, përfshirë masat që kanë si qëllim modifikimin e kërkesave në fushën e higjienës për stabilimentet ose impiantet sipas kërkesave të nenit 25, pika 1;
- c) kushtet dhe përshkrimet teknike për përpunimin, trajtimin, transformimin, prodhimin dhe magazinimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate dhe kushtet për trajtimin e ujerave të rrjedhshëm;
- ç) elementët e provës që operatori duhet të paraqesë me qëllim të miratimit të trajtimit, të transformimit dhe të përpunimit të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate, përkatësisht për masat e vazhdueshme për të evituar rreziqet për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve;
- d) kushtet për përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate të më tepër se një kategorie sipas kërkesave të neneve 8, 9 dhe 10 në të njëjtin stabiliment ose impiant:
  - i) kushtet në të cilat këto veprimtari kryhen të ndara;
  - ii) kushtet në të cilat këto veprimtari kryhen njëkohësisht në rrethana të përcaktuara.
- dh) kushtet për të parandaluar kontaminimin e kryqëzuar kur nënproduktet me origjinë shtazore magazinohen, trajtohen ose transformohen në një pjesë të veçante të një stabilimenti ose impianti sipas kërkesave të nenit 26;
- e) parametra standard të transformimit për impiantet e prodhimit të biogas dhe të kompostit;
- ë) përshkrime të aplikueshme nëpërmjet djegies dhe djegies për prodhimin e energjisë në impiante me kapacitet të ulët dhe të lartë sipas kërkesave të nenit 24, pika 1, gërmat b) dhe c); dhe
- f) masat e aplikueshme për përdorimin si lëndë djegëse të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate sipas nenit 24, pika 1, gërma ç).

3. Masat e përcaktuara ( për nenet 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, dhe 38) mund të aplikohen edhe për:

- a) kushtet për futjen në treg të ushqimeve për kafshët e shoqërimit të importuara ose të ushqimeve për kafshët e shoqërimit të prodhuara duke u nisur nga lëndë të para të importuara që rrjedhin nga materialet e kategorisë 1, sipas kërkesave të nenit 8, gërma c);
  - b) kushtet për prejardhjen e sigurt, spostimin e sigurt të materialeve që do të përdoren me kusht parandalimin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve;
  - c) dokumentacionin sipas kërkesave të nenit 36, pika 2;
  - d) parametrat për procesin e prodhimit sipas kërkesave të nenit 37, nën paragrafi i parë, në veçanti përsa i përket aplikimit të trajtimeve fizike ose kimike mbi materialin e përdorur;
  - e) përshkrimet që i përkasin provave që bëhen mbi produktin përfundimtar; dhe
  - f) kushtet për përdorim të sigurtë të produkteve derivate që paraqesin një rrezik për shëndetin publik dhe të kafshëve.
4. Këshilli i Ministrave miraton masat që zbatohen sipas këtij neni.

## KREU 5

### PËRJASHTIME

#### Neni 16

#### **Përrjashtime**

Në ndryshim nga nenet 12, 13 dhe 14, nënproduktet me origjinë shtazore mund të jenë si vijon:

- a) nënprodukte me origjinë shtazore sipas nenit 15, pika 1, gërma a) mund të përpunohen dhe eliminohen në përputhje me kushtet e veçanta të përcaktuara sipas kërkesave të kësaj gërme;
- b) nënprodukte me origjinë shtazore të cilat mund të përdoren për qëllime kërkimore ose qëllime të tjera të veçanta në përputhje me nenin 17;
- c) nënprodukte me origjinë shtazore sipas nenit 18, të përdorur për qëllime të veçanta në ushqime për kafshë në përputhje me këtë nen;
- ç) nënprodukte me origjinë shtazore sipas nenit 19, eliminohen në përputhje me atë nen;
- d) nënprodukte me origjinë shtazore mund eliminohen ose përdoren nëpërmjet metodave alternative të autorizuara në përputhje me nenin 20, bazuar në parametra që mund të parashikojnë sterilizimin nën presion ose kërkesa të tjera të kësaj rregulloreje ose të masave përkatëse të adoptimit;
- dh) materialet e kategorisë 2 dhe 3, pasi të merret autorizimi i autoriteteve kompetent për kontrollin zyrtar, përdoren në përgatitjen e preparateve biodinamike;
- e) materialet e kategorisë 3, pasi të merret autorizimi i autoriteteve kompetente për kontrollin zyrtar, përdoren për ushqimin e kafshëve të shoqërimit;

ë) nënproduktet me origjinë shtazore, me përjashtim të materialeve të kategorisë 1, të përfituara gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale në kafshët e gjalla ose gjatë pjelljes së kafshëve në fermë eliminohen direkt në fermë pas marrjes së autorizimit nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar.

#### Neni 17

### **Kërkimi shkencor dhe qëllime të tjera të veçanta**

1. Në ndryshim nga nenet 12, 13 dhe 14, autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, mund të lejojë përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate në ekspozita, aktivitete artistike, për qëllime diagnostike, mësimore ose kërkimi shkencor, në zbatim të kushteve të përshtatshme që kontrollojnë rriskun për shëndetin publik dhe të kafshëve. Kushte të tilla përfshijnë:

a) ndalimin e çdo lloj përdorimi të mëvonshëm për qëllime të tjera të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate; dhe

b) detyrimin e eliminimit të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate në mënyre të sigurt, ose ridërgimin kur është e mundur në vëndin e origjinës.

2. Atëherë kur ka rrisk për shëndetin publik ose të kafshëve që kërkojnë marrjen e masave për të gjithë territorin, në veçanti kur bëhet fjalë për rreziqe që janë sapo shfaqur, mund të përcaktohen kushte të bashkërenduara për përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate sipas kërkesave të paragrafit 1. Këto kushte mund të përfshijnë norma që i përkasin magazinimit, ambalazhimit, transportit dhe eliminimit.

#### Neni 18

### **Përdorime të veçanta për ushqimin e kafshëve**

1. Në ndryshim nga parashikimet e nenit 13 dhe 14 dhe në respekt të kushteve të cilat garantojnë kontrollin e rriskut për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, autoriteti kompetent mund të lejojë mbledhjen dhe përdorimin e materialeve të kategorisë 2, me kusht që të mos rrjedhin nga kafshë të eliminuara ose të ngordhura si pasojë e prezencës së dyshuar ose të diagnostikuar të një sëmundje të transmetueshme tek njerëzit ose tek kafshët si dhe të materialeve të kategorisë 3 për ushqimin e:

a) kafshëve të kopshtit zoologjik;

b) kafshëve të cirkut;

c) reptilëve dhe zogjve të gjahut që nuk janë kafshë të kopshtit zoologjik ose të cirkut;

ç) kafshëve të prodhimit të lëkurëve;

d) kafshëve të egra;

dh) qenve në pika grumbullimi të tyre ose qenve të gjahut;



- e) qenve dhe maceve në pika grumbullimi të miratuara;
  - ë) larvave dhe vermeve të destinuara të përdoren si karrem për peshkim.
2. Në ndryshim nga neni 12, autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar mund të lejojë:
- a) përdorimin e materialeve të kategorisë 1 sipas nenit 8, gërma b), pika ii), dhe të materialeve derivate nga kafshë të kopshtit zoologjik për ushqimin e kafshëve të kopshtit zoologjik; dhe
  - b) përdorimin e materialeve të kategorisë 1 sipas nenit 8, gërma b), pika ii), për ushqimin e zogjve nekrofagë të llojeve të mbrojtura ose të kërcënuara nga zhdukja dhe të llojeve të tjera që jetojnë në habitat natyral, me qëllim promovimin e biodiversitetit.

## Neni 19

### Mbledhja, transporti dhe eliminimi

1. Në ndryshim nga parashikimet e neneve 12, 13, 14 dhe 21, të këtij ligji autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, mund të lejojë eliminimin:
- a) nëpërmjet groposjes së kafshëve të shoqërimit dhe njëhundraëve të ngordhur;
  - b) nëpërmjet djegies dhe groposjes në vend ose nëpërmjet mjeteve të tjera, nën kontrollin e veterinarit zyrtar me qëllim që të parandalojnë transmetimin e rriskut për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, të materialeve të kategorisë 1 sipas kërkesave të nenit 8 gërma a), pika v) dhe gërma b), pika ii), të materialeve të kategorisë 2 dhe të kategorisë 3 në zona të izoluara;
  - c) nëpërmjet djegies dhe groposjes në vend ose nëpërmjet mjeteve të tjera, nën kontrollin e veterinarit zyrtar me qëllim që të parandalojnë transmetimin e rriskut për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, të materialeve të kategorisë 1 sipas kërkesave të nenit 8, gërma b), pika ii), të materialeve të kategorisë 2 dhe të 3 në zona në të cilat praktikisht është e pamundur të hyhet ose hyrja për arsye gjeografike, klimaterike ose për arsye të katastrofave natyrore të mundshme mund të paraqesi rrisht për shëndetin dhe sigurinë e personelit të autorizuar për mbledhjen e karkasave ose hyrja bëhet e mundur vetëm duke përdorur mjete të veçanta për mbledhjen e tyre;
  - ç) nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga djegia ose nga groposja në vend, nën kontrollin e veterinarit zyrtar, për materialet e kategorisë 2 dhe të kategorisë 3 që nuk paraqesin rrisht për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve kur sasia e materialeve nuk kalon një volum të përcaktuar në një javë, e përcaktuar në lidhje me natyrën e aktiviteteve të zhvilluara dhe me llojet e kafshëve të origjinës së nënprodukteve me origjinë shtazore në fjalë;
  - d) nëpërmjet djegies ose groposjes në vend, në kushte të përshtatshme për parandalimin e rriskut të transmetimit të sëmundjeve të transmetueshme për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, të nënprodukteve me origjinë shtazore të ndryshme nga materialet e kategorisë 1 sipas nenit 8, gërma a), pika i), në rastet e shpërthimit të një sëmundje objekti i njoftimit të detyruar, atëherë kur transporti në impiantin e miratuar më të afërt për transformim ose për eliminim të nënprodukteve me origjinë shtazore do të rrishte rrishtun e përhapjes ose të

- shtrirjes së mëtejshme të një vatre të një sëmundje epizootike, e cila mund çojë në tejkalimin e kapacitetit eliminues të këtij impianti; dhe
- dh) nëpërmjet djegies ose groposjes në vend, në kushte të përshtatshme për parandalimin e rrishtit të transmetimit të sëmundjeve të transmetueshme për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, të bletëve dhe të produkteve të apikulturës.
2. Popullata e kafshëve të një lloji të caktuar në një zonë të izoluar sipas pikës 1, gërma b), nuk tejkalon një përqëndrim maksimal të caktuar të popullatës së kafshëve në të gjithë territorin.
3. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar mban informacione të përditësuara për sa i përket:
- a) zonave që ata konsiderojnë të izoluar për qëllimet e aplikimit të pikat 1, gërma b) dhe arsytet e konsiderimit si zonë e izoluar, si dhe informacione të përditësuara që i përkasin ndryshimeve të mundshme të konsiderimit si zonë e izoluar; dhe
  - b) autorizimeve të dhëna së sipas pikat 1, gërmat c) dhe ç), për sa i përket materialeve të kategorisë 1 dhe kategorisë 2 ; dhe
4. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar merr masa për sa i përket:
- a) kontrollit të kushteve që kanë si qëllim të garantojnë kontrollin e rrishtit për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve në rastin e djegies dhe të groposjes në vend;
  - b) përcaktimit të përqindjes maksimale të popullatës së kafshëve sipas kërkesave të pikës 2;
  - c) përcaktimit të volumit nënprodukteve me origjinë shtazore, në lidhje me natyrën e aktivitetit dhe të llojeve të origjinës, siç përshkruhet në pikën 1, gërma ç); dhe
  - ç) hartimit të listës së sëmundjeve sipas pikat 1, gërma d).

Neni 20

### **Autorizimi i metodave alternative**

Autorizimi i metodave alternative për përdorimin ose eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose produkteve derivate bëhet nga autoriteti kompetent.

Pocedurat, kriteret dhe rregullat e detajuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## KREU 6

### MBLEDHJA, TRANSPORTI, GJURMUESHMËRIA DHE LICENSIMI

#### Neni 21

#### **Mbledhja, përcaktimi i kategorisë, regjistrimi dhe transporti**

1. Operatorët mbledhin, përcaktojnë kategorinë, regjistrojnë dhe transportojnë nënprodukte me origjinë shtazore pa vonesa të panevojshme, në kushtet e përshtatshme për të parandaluar rrishtun mbi shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve.
2. Operatorët garantojnë se gjatë transportit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate, të shoqërohen me një dokument tregtar ose një certifikatë veterinare. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, mund të autorizojë vetëm transportin e plehut të stallave pa dokument tregtar ose certifikatë veterinare brenda të të njëjtit rajon.
3. Dokumentet tregtare dhe certifikatat veterinare që shoqërojnë nënproduktet me origjinë shtazore ose produktet derivate gjatë transportit përmbajnë të paktën informacionin mbi origjinën, kategorinë, destinacionin, sasinë, përshkrimin e nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate si dhe numrin e licencës.
4. Operatorët mbledhin dhe eliminojnë mbetjet e guzhinës dhe të restorantit të kategorisë 3 në përputhje me masat kombëtare të parashikuara nga legjislacioni i mbetjeve.

#### Neni 22

#### **Gjurmueshmëria**

1. Operatorët që dërgojnë, transportojnë ose marrin nënprodukte me origjinë shtazore ose produkte derivate mbajnë një regjistër të partive të mallit dhe dokumentet ose certifikatat përkatëse.
2. Operatorët e përcaktuar në pikën 1 hartojnë sisteme dhe procedura për të identifikuar:
  - a) operatorët e tjerë të cilëve ju kanë dhënë nënproduktet me origjinë shtazore ose produktet derivate; dhe
  - b) operatorët nga të cilët kanë marrë nënprodukte me origjinë shtazore ose produkte derivate.
3. Këto informacione i vihen në dispozicion autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar me kërkesë të tij.

### **Licencimi i operatorëve, i stabilimenteve ose impianteve**

1. Operatorët e stabilimenteve ose impianteve që grumbullojnë, transportojnë, përpunojnë, tregtojnë, magazinojnë, eliminojnë nënprodukte me origjinë shtazore dhe/ose produkte derivate, licencohen. Me qëllim të licencimit, operatorët duhet që:
  - a) të aplikojnë për licencë, për të gjitha stabilimentet ose impiantet që duan të licencojnë duke përkrahur aktivitetin që duan të ushtrojnë;
  - b) t'i transmetojnë autoritetit kompetent për kontrollin zyrtar informacione mbi:
    - i) kategorinë e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate që do të grumbullojnë, transportojnë, magazinojnë, përpunojnë, tregtojnë, eliminojnë dhe përdorin;
    - ii) natyrën veprimtarive që do të zhvillojnë me nënproduktet me origjinë shtazore ose produktet derivate si dhe materialin fillestar që do të përdorin.
2. Operatorët i japin autoritetit kompetent për kontrollin zyrtar informacione të vazhdueshme për të gjitha stabilimentet ose impiantet sipas kërkesave të pikës 1, gërma a), përfshirë çdo ndryshim thelbësor në aktivitetin ose në rastin kur ata mbyllin një stabiliment ose impiant.
3. Procedura e licencimit:
  - a) pas marrjes së njoftimit nga ana e operatorit autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar kryen një kontroll paraprak për të kryer verifikimin e impianteve dhe në vijim të rezultateve të kontrollit licencën operatorin ose refuzon licencimin duke dhënë arsyet e mos licencimit. Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar mund t'i japë operatorit detyra shtesë për plotësimin e kushteve të licencimit.
  - b) operatori kërkon licencën sipas legjislacionit përkatës për lejet dhe licencat.
  - c) Pas marrjes së licencës operatori njofton autoritetin kompetent për kontrollin zyrtar për marrjen e aktit të licencës
  - ç) pas marrjes së njoftimit se operatori është licencuar autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar kryen një kontroll të dytë me qëllim verifikimin e kushteve të licencimit, në përfundim të të cilit jep miratimin e fillimit të aktivitetit ose refuzimin me arsyet e mosmiratimit.
  - d) pas marrjes së licencës operatori njofton autoritetin kompetent për kontrollin zyrtar për fillimin e aktivitetit.

### **Lejet e ushtrimit të veprimtarive të veçanta nga ana e operatorëve të licencuar**

1. Operatorët marrin leje për stabilimentet ose impiantet e tyre tek autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, atëherë kur këto stabilimente ose impiante zhvillojnë një ose me shumë nga aktivitetet që vijojnë:

- a) trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore nëpërmjet sterilizimit nën presion, me metoda të transformimit sipas nenit 15, pika 1, gërma b) ose metoda alternative sipas përshkrimeve të nenit 20;
- b) eliminimin si mbetje, nëpërmjet djegies së nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate;
- c) eliminimin ose ripërdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate kur ato bëhen mbetje, nëpërmjet djegies për prodhimin e energjisë, përjashtuar stabilimentet ose impiantet funksionimi i të cilave është autorizuar në përputhje me legjislacionin e eliminimit të mbetjeve në inceneratorë;
- ç) përdorimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate si lëndë djegëse;
- d) prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërimit;
- dh) prodhimin e fertilizantëve organikë dhe të plehut organik;
- e) transformimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe/ose produkteve derivate në biogas ose kompost;
- ë) përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore, nëpërmjet veprimtarive si përzgjedhja, prerja, ftohja, ngrirja, heqja e lëkurëve ose materialeve specifike të rrezikshme;
- f) magazinimin e nënprodukteve me origjinë shtazore;
- g) magazinimin e produkteve derivate të destinuara që të:
  - i) eliminohen në landfill, digjen, apo janë të destinuara të ripërdoren ose eliminohen nëpërmjet djegies për prodhim të energjisë;
  - ii) përdoren si lëndë djegëse;
  - iii) përdoren si ushqim për kafshë, përjashtuar stabilimentet ose impiantet e regjistruara ose të miratuara në përputhje me Ligjin e Ushqimit;
  - iv) përdoren si fertilizantë organik dhe pleh organik, përjashtuar magazinimin në vëndin e përdorimit direkt si të tillë.

2. Dhënia lejes sipas pikës 1 përcakton nëse stabilimenti ose impianti miratohet për veprimtari që i përket nënprodukteve me origjinë shtazore dhe/ose produkteve derivate të:

- a) një kategori të veçantë sipas kërkesave të neneve 8, 9 ose 10; ose
- b) të një ose më shumë kategorive sipas kërkesave të neneve 8, 9 ose 10, duke saktësuar nëse këto veprimtari zhvillohen:
  - i) në mënyrë të përhershme në kushtet e ndarjes së plotë të përpunimit të kategorive të ndryshme, me qëllim që të parandalojnë rriskun e mundshëm për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve; ose
  - ii) në mënyrë të përkohshme në kushte që kanë si qëllim të parandalojnë kontaminim, si pasojë e mungesës së mundësive dhe të kapaciteteve për këto produkte si pasojë e një vatre të gjerë të një sëmundje epizootike, ose rrethanave të tjera të jashtëzakonshme të pa parashikuara.

3. Marrin leje pa pasur nevoje të licencohen personat fizik ose juridik të cilët kryejnë vetëm prodhimin e trofeve ose balsamosjen e kafshëve. Leja jepet nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar.

## KREU 7

### HIGJIENA

#### Neni 25

#### **Kërkesa të përgjithshme në fushën e higjienës**

1. Operatorët marrin masa që stabilimentet ose impiantet që zhvillojnë veprimtari sipas nenit 24, pika 1, gërmat a) dhe ë):

a) të jenë ndërtuar në mënyrë që të lejojnë pastrimin dhe dezinfektimin e përshtatshëm, dhe ku është e mundur në mënyrë të tillë që planimetria të lehtësojë largimin e ujërave;

b) të kenë akses në struktura të përshtatshme për higjienën e personelit si: banjë, dhoma zhveshje dhe lavamanë;

c) të kenë mjete të përshtatshme mbrojtëse kundër kafshëve të dëmshme si insekte, brejtës dhe zogj;

ç) të mirëmbajnë impiantët dhe mjetet e punës në kushte të mira dhe të sigurojnë që aparaturat e matjes të jenë të kalibruara rregullisht; dhe

d) të kenë mjete të përshtatshme për pastrim dhe dezinfektim të kontenitorëve dhe të mjeteve të transportit për të evituar rrsikun e kontaminimit.

2. Të gjithë personat që punojnë në stabilimente ose në impiante sipas pikës 1 duhet të veshin rroba pune të përshtatshme, të pastra dhe kur është e nevojshme mbrojtëse.

Në impiant ose stabiliment:

a) punonjësit që kryejnë veprimtari në zona të pista nuk mund të hyjnë në zona të pastra para së të ketë ndërruar rrobat dhe këpucët e punës ose pasi ti kenë dezinfektuar ato;

b) mjetet dhe veglat e punës nuk zhvendosen nga zona e pisët në zonën e pastër, nëse me parë nuk pastrohen dhe dezinfektohen; dhe

c) operatori përcakton një procedurë për zhvendosjen e personelit me qëllim që të kontrollojë lëvizjet dhe përshkruajë përdorimin saktë të mjeteve të punës, larjen e këpucëve të punës dhe të rrotave të mjeteve.

3. Në stabilimente ose impiante që zhvillojnë aktivitet sipas nenit 24, pika 1, gërma a):

a) nënproduktet me origjinë shtazore përpunohen në mënyrë që të mënjanohet rreziku i kontaminimit;

b) nënproduktet me origjinë shtazore transformohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Pas transformimit, nënproduktet me origjinë shtazore përpunohen dhe magazinohen në mënyrë që të evitohet rreziku i kontaminimit;

- c) nëse nevojitet, gjatë trajtimit të një nënprodukti me origjinë shtazore dhe produkti derivat, të gjitha pjesët e nënproduktit me origjinë shtazore dhe produktit derivat trajtohen në një temperaturë të caktuar për një periudhë kohe të caktuar për të evituar rriskun e kontaminimit;
- ç) operatorët kontrollojnë rregullisht parametrat e zbatuara, në veçanti temperaturën, presionin, kohën, përmasat e grimcave, dhe nëse nevojitet nëpërmjet aparaturave automatike;
- d) përcaktohen dhe dokumentohen procedurat e pastrimit për të gjitha pjesët e stabilimentit ose impiantit.

#### Neni 26

### **Përpunimi i nënprodukteve me origjinë shtazore nga operatorët e sektorit ushqimor.**

1. Trajtimi, transformimi ose magazinimi i nënprodukteve me origjinë shtazore në stabilimente ose impiante dhe, nëse nevojitet, në një pjesë të caktuar të stabilimentit ose impiantit, duke respektuar kushtet të cilat parandalojnë kontaminimin e kryqëzuar.
2. Lëndët e para për prodhimin e xhelatinës dhe kolagjenit të cilat nuk janë të destinuara për konsum nga njerëzit mund të magazinohen, trajtohen dhe transformohen në stabilimente me kusht që rrisku i transmetimit të sëmundjeve të parandalohet nëpërmjet ndarjes së këtyre lëndëve të para të përdorura për prodhimin e produkteve me origjinë shtazore.
3. Paragrafët 1 dhe 2 respektojnë zbatimin e kërkesave specifike të parashikuara nga legjislacioni në fushën e veterinarisë.

#### KREU 8

### **KONTROLLET E BRENDSHME, ANALIZA E RRISKUT DHE PIKAT KRITIKE TË KONTROLLIT (HACCP)**

#### Neni 27

### **Vetëkontrolli (HACCP)**

Operatorët hartojnë, zbatojnë kontrole të brendshme në stabiliment ose impiant, me qëllim monitorimin e zbatimit të këtij ligji. Operatorët garantojnë që asnjë nënprodukt shtazor ose produkt derivat për të cilin dyshohet ose është verifikuar jo përputhshmëria me këtë ligj të nxirret nga stabilimenti ose impianti, me përjashtim kur do të bëhet eliminimi i tij.

## Neni 28

### **Analiza e riskut dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP)**

1. Operatorët që zhvillojnë aktivitetin duhet të sigurojnë një sistem vetkontrolli sipas parimeve të analizës së riskut dhe të pikave kritike të kontrollit (HACCP) për:
  - a) përpunimin e nënprodukteve me origjinë shtazore;
  - b) transformimin e nënprodukteve me origjinë shtazore në biogas dhe kompost;
  - c) përpunimin edhe magazinimin e një ose me shume kategorie të nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate në të njëjtin stabiliment ose impiant;
  - ç) prodhimin e ushqimeve për kafshët e shoqërimit.
2. Operatorët e përcaktuar në pikën 1, në veçanti:
  - a) identifikojnë të gjitha rrisqet që duhet të parandalohen, eliminohen ose duhen zvogëluar në nivele të pranueshme;
  - b) identifikojnë pikat kritike të kontrollit në fazën ose fazat në të cilat vetkontrolli është themelor për të parandaluar ose eliminuar një rrezik ose për ta ulur atë në nivele të pranueshme;
  - c) përcaktimi i limiteve kritike për pikat kritike të kontrollit me qëllim parandalimin, eliminimin ose uljen e nivelit të rrezikut të identifikuar ;
  - ç) përcaktojnë dhe aplikojnë procedura të efektshme të mbikëqyrjes në pikat kritike të kontrollit;
  - d) përcaktojnë masat korrigjuese që duhet të merren në rastet në të cilat nga rezultatet e monitorimit rezulton që një pikë e kontrollit kritik nuk është në normë;
  - dh) përcaktojnë procedura për të verifikuar që masat e përshkruara nga gërma a) tek gërma d) janë komplete dhe funksionojnë në mënyrën e duhur. Procedurat e verifikimit zhvillohen në mënyrë të rregullt.
  - e) përcaktojnë një dokumentacion dhe regjistra të përshtatshëm me natyrën dhe përmasat e biznesit, në mënyrë që të demonstrojnë që zbatimi i masave është marrë sipas kërkesave të gërmave nga a) në dh).
3. Sa herë që bëhet një ndryshim në produkt, në proces ose në çdo faze të prodhimit, transformimit, magazinimit, operatorët bëjnë ndryshimet e nevojshme dhe në procedura.

## Neni 29

### **Manualet kombëtare të praktikave me të mira**

Autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar harton, shpërndan manualët kombëtare të praktikave me të mira, në veçanti për aplikimin e principeve të (HACCP) sipas kërkesave të nenit 28. Operatorët mund të përdorin këto manuale mbi bazë vullnetare.



## KREU 9

### TREGTIMI

#### Neni 30

#### **Futja në treg**

1. Nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate të destinuara për ushqimin e kafshëve, që prodhojnë ushqime të ndryshme nga kafshët për prodhimin e lëkurëve mund të futen në treg me kushtin që:

- a) të jenë ose të rrjedhin nga materiale të kategorisë 3 të ndryshme nga materialet e përcaktuara në nenin 10, gërmat j), k) dhe l);
- b) të jenë mbledhur ose trajtuar, sipas rastit, në respekt të kushteve të përcaktuara për sterilizim nën presion ose kushte të tjera të përshtshme që të parandalojnë rreziqet për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, në përputhje me masat e marra sipas kërkesave të nenit 15 dhe të masave të mundshme të marra sipas kërkesave të pikës 2 të këtij neni; dhe
- c) të vijnë nga stabilimente ose impiante të licencuara, sipas nënprodukteve me origjinë shtazore ose të produkteve derivate për të cilat bëhet fjalë.

2. Masat e zbatimit të këtij neni mund të përcaktohen përsa i përket kushteve të shëndetit publik ose të kafshëve për mbledhjen, transformimin dhe trajtimin e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe të produkteve derivate sipas pikës 1.

#### Neni 31

#### **Futja në treg dhe përdorimi i fertilizantëve organik dhe plehut organik**

1. Fertilizantët organik dhe plehu organik mund të futen në treg dhe të përdoren me kusht që:

- a) të rrjedhin nga materiale të kategorisë 2 ose të kategorisë 3;
- b) të jenë mbledhur ose trajtuar, sipas rastit, në respekt të kushteve të përcaktuara për sterilizim nën presion ose kushte të tjera të përshtatshme që të parandalojnë rreziqet për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve në përputhje me masat e marra sipas kërkesave të nenit 15 dhe të masave të mundshme të marra sipas kërkesave të pikës 3 të këtij neni;
- c) të vijnë nga stabilimente ose impiante të licencuara, sipas rastit;
- ç) mielli i mishit dhe i kockave të rrjedhura nga materiale të kategorisë 2 dhe proteinave shtazore të transformuara, të destinuara që të përdoren si fertilizantë organik dhe pleh organik ose përbërës të tyre, të jenë përzier me një markues me qëllim që të parandalohet përdorimi i mëtejshëm në përzierje si ushqim për kafshë.

Futen në treg dhe përdoren si fertilizantë organik ose pleh organik, mbetjet që rrjedhin nga transformimi në biogas ose kompost.

2. Në ndryshim nga paragrafi 1, gërma ç), nuk është e nevojshme përzierja me materiale inerte kur përdorimi i të cilave si ushqim për kafshë, është përjashtuar si rezultat i përbërjes ose ambalazhimit të tyre.

3. Masat e zbatimit të këtij neni përcaktohen për:

a) kushtet e shëndetit për njerëz dhe shëndetit të kafshëve për prodhimin dhe përdorimin e fertilizantëve dhe plehut organik;

b) përbërësit dhe substancat për markimin e fertilizantëve organik dhe plehut organik;

c) përbërësve që do të përzihen me fertilizantët dhe plehun organik;

ç) kushtet shtesë, p.sh. metodat që duhet të përdoren për identifikimin dhe sasi të minimale që duhet të respektohen në përgatitjen e përzjerjeve me qëllim që të përjashtohet përdorimi i këtyre fertilizanteve dhe plehrave organik si ushqime për kafshë; dhe

d) rastet në të cilat përbërja ose ambalazhi lejojnë përjashtimin nga detyrimi i përzjerjes së përbërësve.

#### Neni 32

### **Produktet derivate të rregulluar nga akte legislative të tjera**

Operatorët mund të fusin në treg produktet derivate si:

a) produkte kozmetike, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës;

b) aparatura mjekësore të implantueshme aktive, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës;

c) aparatura mjekësore, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës;

ç) aparatura mjekësore diagnostike “in vitro”, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës;

d) barna veterinare, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës;

dh) barna, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

#### Neni 33

### **Prodhimi**

1. Importimi, mbledhja dhe lëvizja e nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate të destinuar për stabilimentet ose impiantet për prodhimin e produkteve derivate sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe prodhimin e këtyre produkteve derivate bëhen duke respektuar legjislacionin përkatës.

Materialet e pa përdorura që vijnë nga këto stabilimente ose impiante eliminohen duke respektuar legjislacionin e cituar më lart.

2. Në përjashtim të parashikimeve të pikës 1 të këtij neni zbatohen kërkesat e këtij ligji për eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore atëherë kur legjislacioni i përshkruar sipas nenit 32, nuk përmbush kushtet e vendosura për parandalimin e rrishtit të mundshëm për shëndetin publik ose të kafshëve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

#### Neni 34

### **Futja në treg e ushqimeve për kafshët e shoqërimin**

Operatorët mund të fusin në treg ushqime për kafshët e shoqërimin, me kusht që:

- a) këto produkte të rrjedhin:
  - i) nga materiale të kategorisë 3 të ndryshme nga materialet e përshkruara nga **neni** 10 gërmat j), k) dhe l);
  - iii) për ushqimet e kafshëve të shoqërimin të pa përpunuara, nga materialet e përcaktuara në përshkrimet e nenit 10 gërma a) dhe gërma b), pikat i) dhe ii); dhe
- b) të garantojnë kontrollin e rriskut për shëndetin publik dhe të kafshëve nëpërmjet trajtimit të sigurt në përputhje me kërkesat e nenit 37, atëherë kur prejardhja e sigurt në përputhje me nenin 36, nuk garanton një mbrojtje të sigurt.

#### Neni 35

### **Futja në treg e produkteve të tjera derivate**

Operatorët mund të fusin në treg produkte derivate të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenet 30, 31, 32 dhe 34 me kusht që:

- a) këto produkte të:
  - i) mos jenë të destinuara të përdoren si ushqim për kafshët që prodhojnë ushqim, ose të përdoren direkt në toka të destinuara si kullota ose kultura të gjelbërta për këto kafshë; ose
  - ii) të jenë të destinuara të përdoren si ushqim për kafshët për prodhimin e lëkurëve;
- b) të garantojnë kontrollin e rriskut për shëndetin publik ose të kafshëve nëpërmjet:
  - i) prejardhjes së sigurtë në përputhje me nenin 36;
  - ii) trajtimit të sigurtë në përputhje me nenin 37 atëherë kur prejardhja e sigurtë nuk garanton mbrojtje të mjaftueshme;
  - iii) duke verifikuar që produktet të jenë përdorur për qëllime përfundimtare të sigurta në përputhje me nenin 38, atëherë kur trajtimi i sigurt nuk garanton mbrojtje të mjaftueshme.

#### Neni 36

### **Prejardhja e sigurtë**

1. Në kuadër të prejardhjes së sigurtë përdoren materiale:

- a) që nuk paraqesin rrisht për shëndetin publik dhe të kafshëve;

- b) që janë mbledhur dhe transportuar nga pika e grumbullimit në stabilimentin ose impiantin e përpunimit në kushte të përshtatshme që bëjnë të mundur parandalimin e rriskut për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve; ose
- c) që janë importuar dhe transportuar nga pika e hyrjes për në stabiliment ose impiantin e përpunimit, në kushte të përshtatshme që bëjnë të mundur parandalimin e rriskut për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve.
2. Për qëllimet e prejardhjes së sigurtë, operatorët mbajnë një dokumentacion në përputhje me përshkrimet e pikës 1, përfshirë aty ku është e nevojshme provën e efektshmerisë së masave të biosigurisë, të marra me qëllim përjashtimin e rriskut për shëndetin publik dhe të kafshëve që rrjedhin nga materiali fillestar. Ky dokumentacion i vihet në dispozicion autoritetit kompetent për kontrollin zyrtar me kërkesë të tij.
3. Në rastin e parashikuar nga pika 1, gërma c), partitë e mallit pajisen me një certifikate veterinare sipas modelit të miratuar.

Neni 37

### **Trajtimi i sigurtë**

1. Trajtimi i sigurt përfshin aplikimin mbi materialet e përdorura, të një procesi prodhimi që bën të mundur uljen në një nivel të pranishëm të rriskut për shëndetin publik dhe të kafshëve nga materialet e përdorura dhe nga substanca të tjera që rezultojnë nga procesi i prodhimit.
2. Të garantohet që produktet derivate të mos sjellin rrisht për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve, në veçanti duke kryer prova mbi produktin përfundimtar.

Neni 38

### **Përdorime përfundimtare të sigurta**

Përdorimet përfundimtare të sigurta përfshin përdorimin e produkteve derivate:

- a) në kushtet në të cilat produktet derivate nuk përbëjnë rrisht për shëndetin publik dhe shëndetin kafshëve;
- b) që mund të paraqesin rrisht për shëndetin publik dhe shëndetin e kafshëve por që përdoren për qëllime specifike, me kusht që përdorimi specifik të jetë i argumentuar në bazë të kërkesave të parashikuara në legjislacionin përkatës për shëndetin publik dhe shëndetin e kafshëve.

## KREU 10

### IMPORTI, TRANSITI DHE EKSPORTI

#### Neni 39

#### **Importi dhe transiti**

1. Nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate që importohen ose transitojnë nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, plotësojnë:
  - a) kërkesat e këtij ligji dhe të masave të tjera zbatuese që i përkasin nënprodukteve me origjinë shtazore ose/dhe produkteve derivate;
  - b) për nënproduktet me origjinë shtazore dhe produktet derivate të përshkruara në nenet 32, 34 dhe 35, dhe plotësojnë veçanërisht kërkesat e këtyre neneve.
2. Ndalohet importi dhe/ose transiti i materialeve të kategorisë 1 dhe/ose 2.
3. Importi i materialeve të kategorisë 3 është i lejuar vetëm për qëllimet e përpunimit dhe prodhimit të produkteve derivate. Ndalohet importi i materialeve të kategorisë 3 për qëllimet e eliminimit të tyre nëpërmjet grososjes ose/dhe djegies për përdorimin në impiante për prodhim të biogazit ose kompostit. Importi bëhet vetëm pasi të jete informuar 72 orë me parë dhe të jetë marrë miratimi i autoritetit kompetent për kontrollin zyrtar për secilën parti.

#### Neni 40

#### **Eksporti**

1. Eksporti i nënprodukteve me origjinë shtazore dhe i produkteve derivate të destinuara për djegie ose grososje është i ndaluar.
2. Eksporti i nënprodukteve me origjinë shtazore të kategorisë 3 dhe i produkteve derivate bëhet vetëm nëse plotësojnë kërkesat e këtij ligji dhe/ose sipas marrëveshjeve tregtare të operatorëve ose kur kërkohet nga vendi importues, me marrëveshje dy ose shumëpalëshe në mes autoriteteve kompetente të vendeve të interesuara.

## KREU 11

### KONTROLLE ZYRTARE DHE KËRKESA PËRFUNDIMTARE

#### Neni 41

##### **Procedura e licencimit dhe dhënies së lejeve**

1. Licencimi bëhet vetëm pasi autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar ka kryer një inspektim në vend para fillimit të çdo lloj aktiviteti, nga i cili rezulton se janë plotësuar kërkesat e këtij ligji dhe akteve të tjera të miratuara në zbatim të këtij ligji.
2. Operatorët garantojnë që një stabiliment ose impiant pushon së vepruari nëse autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, i pezullon ose i heq atij licencën dhe/ose lejen e ushtrimit të aktivitetit.

#### Neni 42

##### **Pezullimi dhe heqja e lejes dhe licencës**

Nëse nga kontrollet zyrtare dhe nga inspektimet e kryera nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar rezulton se një ose me shumë kërkesa të këtij ligji nuk janë plotësuar, ky i fundit:

a) *pezullon aktivitetin* ose dhe lejen/licencën e stabilimentit ose impiantit të miratuar bazuar në këtë ligj, nëse:

- i) kushtet për dhënien e lejes/licencës ose mbi funksionimin e stabilimentit ose impiantit nuk janë përmbushur;
- ii) gjykohet që operatori nuk i ka plotësuar prej kohësh mangësitë e gjetura; dhe
- iii) rreziqet e mundshme për shëndetin publik dhe të kafshëve nuk kërkojnë zbatim të pikës b);

b) *heq licencën/lejen* stabilimentit ose impiantit të miratuar në këtij ligji, nëse:

- i) kushtet për miratimin ose funksionimin e stabilimentit ose impiantit nuk përmbushen më; dhe
- ii) gjykohet që operatori nuk do të jetë në gjendje të përmbushë mangësitë e gjetura brenda një kohë të arsyeshme, që janë të lidhura me infrastrukturën e stabilimentit/ impiantit, me kapacitetet personale të operatorit ose të personelit që ai kontrollon, ose për shkak të rreziqeve të rënda për shëndetin publik ose të kafshëve të cilat kërkojnë modifikime të mëdha të funksionimit të stabilimentit/ impiantit para se operatori të mund të paraqesë një kërkesë të re për leje/licencë;

c) *urdhëron stabilimentin* të përmbushë detyrime konkrete, të vendosura nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar, për të plotësuar mangësitë e gjetura.

#### Neni 43

### **Regjistrat, cerifikat veterinare dhe listat e kontrollit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe produkteve derivate**

1. Nënproduktet me origjinë shtazore lëvizin brenda territorit, importohen dhe eksportohen vetëm nëse janë të pajisur me certifikate veterinare.
2. Modeli dhe përmbajtja e certifikatës veterinare miratohet me urdhër Ministri me propozim të autoritetit kompetent për kontrollin zyrtar.
3. Modeli dhe përmbajtja e regjistrave dhe listave të kontrollit miratohet nga autoriteti kompetent për kontrollin zyrtar.

#### KREU 12

### MASAT NDALUESE DHE KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

#### Neni 44

### **Masa ndaluese**

1. Është e ndaluar hedhja dhe eliminimi e nënprodukteve shtazore, derivateve të tyre dhe mbetjeve me prejardhje shtazore:
  - a) në vende që nuk janë autorizuar nga autoritetet kompetente;
  - b) në mjediset urbane: sheshe, rrugë, në kazanët e mbledhjes së mbetjeve urbane;
  - c) në det, basene ujore natyrale dhe artificiale dhe ledhe natyrale. Ndalohet hedhja për qëllim eliminimi e të gjitha nënprodukteve me prejardhje nga kafshët e tokës dhe të gjitha nënprodukteve me prejardhje nga kafshët e ujit, me përjashtim të nënprodukteve që janë të përpunuara si ushqim për peshqit në basenet e mbarështimit të tij.
2. Është e ndaluar hedhja, groposja, braktisja dhe djegia e nënprodukteve shtazore në fusha, në kodra, në pyje dhe çdo ambient tjetër rural.
3. Është e ndaluar braktisja e kadavrave të kafshëve të shoqërimit.
4. Është i ndaluar përdorimi i miellit të mishit dhe të kockave direkt në tokë si fertilizantë organik. Mielli i Mishit dhe i kockave përdoret për prodhimin e fertilizantëve sipas legjisllacionit për prodhimin e tyre.

## Neni 45

### Kontratat e bashkëpunimit

1. Operatorët e biznesit të licencuar për mbarështimin e kafshëve, therjen e kafshëve, mbarështimin e peshkut, përpunimin e peshkut tregtimin për prodhimin e ushqimeve për njerëz që janë ose përmbajnë produkte shtazore për konsum për njerëz, të cilët nuk i përpunojnë nënproduktet shtazore që ata krijojnë gjatë procesit të mbarështimit dhe/ose të prodhimit, lidhin një kontratë me një grumbullues të nënprodukteve me origjinë shtazore, impiant ose stabiliment të licencuar për përpunimin ose/dhe eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore.
2. Operatorët e biznesit që heqin nga tregu ushqime të cilat nuk mund të përdoren për njerëz kur ato dëmtohen, prishen, skadojnë, nuk shiten, teprojnë ose konfiskohen gjatë kontrolleve zyrtare, lidhin një kontratë me një grumbullues, impiant ose stabiliment të licencuar për përpunimin e nënprodukteve shtazore ose/dhe eliminimin e tyre.
3. Operatorët të cilët prodhojnë ushqim për konsum direkt për njerëz si ushqim i freskët (guzhina, restorante, mensa dhe operatorë të tjerë të ngjashëm) lidhin një kontratë bashkëpunimi me një operator të licencuar për grumbullimin, përpunimin ose eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore kur ato nuk depozitohen si mbetje.
4. Lidhja e kontratës sipas pikave 1, 2 dhe 3 është e detyrueshme dhe është kusht i licencimit të aktivitetit primar. Mos pajisja me kontratë sipas pikave 1, 2 dhe 3, brënda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji përbën shkak për heqjen e menjëhershme të licencës për ushtrimin e aktivitetit primar.
5. Kontrata sipas kërkesave të këtij ligji është pjesë e dokumenteve të licencimit për të gjithë operatorët e biznesit ushqimor.
6. Operatorët e biznesit ushqimor kanë mundësinë që të licencohen edhe për eliminimin e nënprodukteve me origjinë shtazore që prodhojnë gjatë procesit të prodhimit ushqimor.
7. Fermerët lidhin kontratë ose licencohen për përpunimin ose eliminimin e nënprodukteve që prodhojnë me përjashtim të përdorimit të plehut të stallës për të prodhuar pleh organik i cili do të përdoret në fermën e tyre pa u tjetërsuar tek të tretët.
8. Operatorët të cilët lidhin kontratë bashkëpunimi me grumbullues dhe përpunues sipas pikës 1 të këtij neni, por nesë kontrata nuk parashikon marrjen e të gjithë masës së nënprodukteve të prodhuara, janë të detyruar të lidhin edhe një kontratë me një operator të licencuar për eliminimin e nënprodukteve.
9. Kontrata e bashkëpunimit përmban, të paktën;
  - a) kategorinë e materialit sipas neneve 8,9,dhe 10 të këtij ligji;
  - b) mënyrën e transportit të materialeve sipas këtij legjislacioni dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
  - c) marrëveshjen financiare ndërmjet prodhuesit të nënprodukteve me origjinë shtazore dhe grumbulluesit, përpunuesit dhe/ose operatorit që bën eliminimin.



**Kundërvajtjet administrative**

Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Përdorimi i nënprodukteve shtazore dhe produkteve derivate në kundërshtim me nenit 11, pika 1, me gjobë 1.000.000 ( një milion) deri në 1.500.000 ( 1 milion e pesëqind mijë lekë).
2. Eliminimi ose përdorimi i materialeve të kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 13, me gjobë nga 500.000 (pesëqind mijë) deri në 1.000.000 (një milion) lekë.
3. Mos respektimi i kërkesave të nenit 21 dhe nenit 22, me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë.
4. Operatorët të cilët janë të detyruar të bëjnë markimin e materialeve, me gjobë nga 1.000.000 ( një milion) deri në 1.500.000 ( një milion e pesëqind mijë) lekë.
5. Operatori i cili është i detyruar të njoftojë autoritetin kompetent të kontrollit në shkelje të nenit 23 pika 1, aplikohet masa me gjobë 1.000.000 (një milion) deri në 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë).
6. Operatori që vazhdon veprimtarinë atëherë kur leja/licenca i është pezulluar ose hequr, gjobitet nga 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë) deri në 2.000.000 ( dy milion lekë).
7. Operatorët që nuk informojnë autoritetin kompetent për kontrollin zyrtar dhe/ose nuk bëjnë përditësimin e licencës sipas nenit 23, pika 2, gjobitet nga 10.000 ( dhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
8. Veprimi në kundërshtim me parashikimet e nenit 44, aplikohet masa me gjobë nga 1.500.000 (1 milion e pesëqind mijë lekë) deri në 2.000.000 ( dy milion lekë).
9. Operatorët të cilët në kundërshtim me nenin 45 nuk kanë një kontratë bashkëpunimi me një impiant të licencuar, nuk licensohen ose për subjektet e licensura perpara hyrjes në fuqi të këtij ligji ju hiqet licenca nese nuk lidhin nje kontratë bashkëpunimi në përputhje me kërkesat e këtij ligji.
10. Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat specifike të transformimit të materialeve të kategorisë 1, 2 dhe 3, aplikohet masa me gjobë nga 10.000 ( dhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
11. Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat e prodhimit të biogas dhe të kompostit, aplikohet masa me gjobë nga 100.000 ( njëqind mijë) deri në 500.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
12. Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat në fushën e higjienës dhe të sistemit të vetkontrollit (HACCP) , aplikohet mas me gjobë nga 10.000 ( dhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
13. Operatorët që nuk plotësojnë parametrat standarde të transformimit, masa me gjobë nga 10.000 (dhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

14. Operatorët që nuk plotësojnë kërkesat në fushën e përpunimit të nënprodukteve shtazore sipas përshkrimeve të nenit 26, pika 1, aplikohet masa me gjobë nga 10.000 ( dhjetë mijë) deri në 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
15. Nëse operatorët fusin në treg nënprodukte shtazore dhe produkte derivate të destinuara për kafshët e mbarështimit, pa respektuar kërkesat e nenit 30, aplikohet masa me gjobë 1.000.000 (një milion lekë) deri në 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.
16. Nëse operatorët fusin në treg dhe përdorin fertilizantë organikë dhe pleh organik pa respektuar kërkesat e nenit 31, aplikohet masa me gjobë nga 500.000 (pesëqind mijë) deri në 1.000.000 (një milion) lekë.
17. Nëse operatorët fusin në treg ushqim për kafshët e shoqërimit pa respektuar kërkesat e nenit 34, me gjobë nga 500.000 (pesëqind mijë) deri në 1.000.000 (një milion) lekë.
18. Nëse operatorët fusin në treg produkte derivate pa respektuar kërkesat e përgjithshme sipas përshkrimeve të neneve 35, 36, 37, dhe 38 me gjobë nga 500.000 (pesëqind mijë) deri në 1.000.000 (një milion) lekë.
19. Kushdo që fut në treg, importon lëkurë të kafshëve të cilat i janë nënshtruar një trajtimi mjekësor veterinar të paligjshëm, zorrë të ruminanteve me ose pa përmbajtje, kocka ose produkte me bazë kockat, që përmbajnë kockat e shtyllës kurrizore dhe të kafkës pa autorizimin përkatës, aplikohet masa me gjobë 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë) deri në 2.000.000 (dy milion lekë).
20. Kushdo që importon ose/dhe eksporton nënprodukte shtazore dhe produkte derivate me qëllim eliminimin nëpërmjet groposjes ose djegies, aplikohet masa me gjobë 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë lekë) deri në 2.000.000 (dy milion lekë).

Neni 47

### **Pagesa e dëmeve të shkaktuara**

Individët dhe subjektet që me veprimet dhe mosveprimet e tyre shkaktojnë dëme që mund të përlojariten në vlerë financiare, përveç shlyerjes së masave administrative, paguajnë vlerat e plotë të dëmeve të shkaktuara dhe vlerën për rekuperimin e tyre.

Neni 48

### **Ankimi**

Ankimi lidhur me masat administrative të nxjerra sipas këtij ligji bëhen sipas Kodit të Procedurave Administrative.

## KREU 13

### DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 50

#### **Dispozita kalimtare**

Operatorët e licencuar për përpunimin, grumbullimin, eliminimin, transportin dhe përdorimin e nënprodukteve shtazore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilë janë licencuar duke u bazuar në ligje të tjera, plotësojnë kërkesat e licencimit sipas këtij ligji brenda 8 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 51

#### **Shfuqizime dhe ndryshime**

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen:

#### ***1.Në ligjin “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”:***

- a) Neni 1:
  - i). pika 6 togfjalëshi “mbeturinat e kafshëve” shfuqizohet;
  - ii). pika 10 ndryshon në “të sigurojë kategorizimin e kafshëve të ngordhura dhe nënprodukteve me origjinë shtazore”
- b) Neni 4:
  - i). pika 35/1 shfuqizohet;
  - ii). pika 53 shfuqizohet;
  - iii). pika 64 shfuqizohet;
- c) Neni 53:
  - i). gërma d) ndryshon në “ ndalohe të ushqehen kafshët e mbarështuara me mbetje që rrjedhin nga guzhinat dhe restorantet dhe që përmbajnë proteina me origjinë shtazore, me përjashtim të të ushqyerit të kafshëve që mbarështohen vetëm për prodhimin e gëzofëve sipas parashikimeve të ligjit ”Për nënproduktet me origjinë shtazore”;

- ii). gërmat e) dhe ë) shfuqizohen;
- ç) Neni 54:
  - i). pika 1) gërma ç) ndryshon në: “Organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore krijojnë qendrat e grumbullimit të nënprodukteve shtazore të mbledhura në territorin e tij dhe lidh kontratë me një operator përpunues të licencuar ose me një landfill të licencuar për eliminimin e tyre.”
  - ii). Pika 1) gërma d) ndryshon në: “mbledhin kadavrat e kafshëve të shoqërimit të ngordhura të dorëzuara nga qytetarët dhe të kafshëve endacake”
- d) Neni 63, shfuqizohet.
- dh) Kreu V dhe neni 78, neni 79, neni 80, dhe neni 81 shfuqizohen.
- e) Kudo në ligj: togfjalëshi “mbeturina, -ve, -at me origjinë shtazore” zëvendësohet me togfjalëshin “nënprodukte me origjinë shtazore”.

**2. Ndryshime në Ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**

- a) neni 36 shfuqizohet;
- b) neni 62, pika 34 shfuqizohet.

**3. Ndryshime në Ligj nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”**

Në aneksin e ligjit, shtohet kategoria nr. 10 me këtë përmbajtje: “Grumbullimi, përpunimi, magazinimi, transporti, tregtimi, përdorimi, eliminimi i nënprodukteve me origjinë shtazore që nuk konsumohen nga njeriu dhe produkteve derivate”.

Neni 52

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 shkurt 2026.